

# **UDHËZIM PËR PUBLIKIM NË REVISTA SHKENCORE NË DISIPLINAT E SHKENCAVE SOCIALE DHE SHKENCAVE HUMANE**

ORCA në kuadër të aktiviteteve të saj për ngritjen e integritetit akademik e ka përpiluar një listë të revistave të cilat i plotësojnë kriteret minimale të parapara në statutin e UP-së si revista shkencore me recension ndërkombëtar. Këto mijëra revista janë kryesisht nga fusha e gjuhës, letërsisë, historisë dhe disiplinat e ndryshme të arteve.

## PSE E KEMI PËRPILUAR KËTË LISTË?

Pjesëtarët e stafit akademik nga **fusha e gjuhës, letërsisë, historisë dhe disiplinat e ndryshme të arteve** kanë qenë të zëshëm në insistimin se nuk mund t'i përmbushin kriteret statutare për avancime akademike pikërisht për shkak se nuk arrijnë të gjejnë revista ndërkombëtare që t'i publikojnë punimet e tyre. ORCA vjen si ndihmë duke u angazhuar në identifikimin e revistave shkencore sipas kategorive me qëllim të rritjes së mundësive për publikim nga ana e profesorëve nga Fakulteti Filologjik, Fakulteti Filozofik dhe Fakulteti i Arteve.

ORCA ka përpiluar një listë të tillë, e cila brenda saj ka me mijëra revista në të cilat stafi akademik i fushave të përmendura mund të publikojë punime. Hulumtuesit e ORCA-s të mbikëqyrur nga konsulentë me përvojë janë përqendruar kryesisht në revista të indeksuara në institucione serioze ndërkombëtare, si: SCOPUS (lista e revistave nga SciMago JR) dhe Web of Science (platformat: Arts & Humanities Citation Index, Social Sciences Citation Index dhe Emerging Sources Citation Index) Ky përcaktim vjen edhe për shkak të njohjes së këtyre databazave nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në dokumentet e saj zyrtare. Madje projektet e botimit në këto platforma mbështeten edhe financiarisht nga MASHT.

Mirëpo, për t'i ikur monopolizimit të publikimeve dhe për ta rritur lirinë akademik ORCA ka listuar revista të cilat janë pjesë e shtëpive botuese si: Taylor & Francis, Springer dhe Elsevier.

Gjatë hulumtimit për listimin e këtyre revistave ORCA ka parë mundësi të mëdha publikimi në këto revista për shkak të moslëvrimit të temave që lidhen me shoqërinë kosovare dhe kulturën shqiptare e që trajtohen aktualisht nga pak akademikë e hulumtues nga vende të ndryshme në revistat e listuara.

# SHEMBUJ TË PUNIMEVE SHKENCORE NGA SHKENCAT SOCIALE DHE SHKENCAT HUMANE

Në vijim paraqiten disa shembuj të punimeve të publikura në revista të këtyre listave si ilustrim me shembuj që paraqesin mundësi për publikim nga Kosova. ORCA ka parë mundësi që artikuj të kësaj natyre të publikohen edhe nga autorët vendorë.

1.

Revista "[Morphology](#)", të cilën e boton shtëpia botuese "Springer", pranon artikuj që kontribuojnë në zhvillimin dhe artikullimin e mëtejshëm të teorisë morfologjike dhe të teorisë gjuhësore në përgjithësi. Artikujt e publikuar në këtë revistë japin të dhëna të reja dhe origjinale nga fusha morfologjisë. Përveç tjerash, revista pranon edhe artikuj që shtjellojnë analiza të hollësishme të gjuhëve specifike dhe analiza krahasuese ndër-gjuhësore, të fakteve relevante që ofrojnë dëshmi relevante empirike për pretendimet teorike të këtyre analizave. P.sh. në vijim po e japim një artikull të publikuar në revistën "[Morphology](#)", në të cilën autorët e tajtojnë shpërndarjen e prapash-tesave njëjëse femërore "et" dhe "a" në kohën e tashme të paradigmave të foljeve hebraike.

## Shembull:

*"[Multiple defaults: feminine -et and -a in Hebrew present tense](#), Morphology, September 2016, Volume 26, Issue 3-4, Pages 399-423."*

2.

Revista "[Ethnomusicology Forum](#)", të cilën e boton shtëpia botuese "Taylor&Francis", pranon artikuj që prezantojnë të menduarit e ri në fushën e etnomuzikologjisë, e definuar gjerësisht si studimi i "njerëzve që bëjnë muzikë". Revista po ashtu pranon artikuj që përfshijnë studimin e të gjithë muzikës, duke përfshirë muzikën e artit perëndimor dhe muzikën popullore. Në vijim po e japim një artikull të publikuar në revistën "[Ethnomusicology Forum](#)", në të cilën autori e trajton një tregim etnografik të muzikës xhaz në Athinë. Autori i këtij artikulli nxjerr në pah debatet e kozmopolitizmit të thirrur përmes krijimit të muzikës lokale të xhazit. Materiali etnografik i paraqitur në këtë artikull synon të ilustrojë se si edhe një subkulturë e vogël mund të shërbejë për të kundërshtuar imagjinatën kozmopolitane.

## Shembull:

*"[Jazz in Athens: Frustrated Cosmopolitans in a Music Subculture](#), Ethnomusicology Forum, Volume 20, 2011 - Issue 2, Pages 175-199."*

3.

Revista "[Translation Review](#)", të cilën e boton shtëpia botuese "Taylor& Francis", pranon artikuj që trajtojnë aspektet krijuese, kulturore, teorike dhe kritika të përkthimeve të ndryshme. Në vijim po e japim një artikull të publikuar në revistën "[Translation Review](#)". Në këtë artikull autori nga Australia merret me studimin e veprave të shkrimtarit shqiptar Ismail Kadare.

**Shembull:**

*"[Ismail Kadare: Modern Homer or Albanian Dissident](#), Translation Review, Volume 76, 2008 - Issue 1, Pages 23-27."*

4.

Revista "[Journal of Balkan and Near Eastern Studies](#)", të cilën e boton shtëpia botuese "Taylor& Francis", pranon artikuj që trajtojnë çështje komplekse historike, ekonomike, politike, diplomatike, kulturore dhe të sigurisë që ballafaqohet rajoni i Ballkanit dhe Lindja e Afërt. Kjo revistë është vazhdimësi e revistës "Journal of Southern Europe and the Balkans Online". Në vijim po e japim një artikull të publikuar në revistën "Journal of Southern Europe and the Balkans Online" të autorit Thomas Emmert. Në këtë artikull Thomas Emmert i ka dhënë disa vërejtje dhe kritika librit të Noel Malcolm të titulluar "Kosovo: A Short History". Noel Malcolm në të njëjtën revistë përmes një artikulli iu ka përgjigjur kritikave të Thomas Emmert.

**Shembull:**

*"[Thomas Emmert, Challenging myth in a short history of Kosovo](#), Journal of Southern Europe and the Balkans Online, Volume 1, 1999 - Issue 2, Pages 217-221."*

*"Noel Malcolm, [Debate: Response to Thomas Emmert](#), Journal of Southern Europe and the Balkans Online, Volume 2, 2000 - Issue 1, Pages 121-124."*

# LISTA E PLATFORMAVE INDEKSUESE ME REVISTAT RESPEKTIKVE

## • Revistat e indeksuara në SciMago JR

SCImago JR është një platformë e cila e llogarit ndikimin e një reviste përmes numrit të citimeve të marra nga një revistë tjetër. SCImago JR të dhënat i merr nga SCOPUS. Për më shumë, vizitoheni vegëzën këtu

- [Letërsi dhe Teori e Letërsisë](#)
- [Arte dhe Skenca Humane](#)
- [Arte Pamore dhe Arte Performative](#)
- [Histori](#)
- [Histori dhe Filozofi e Shkencës](#)

## • Revistat e indeksuara në [Arts & Humanities Citation Index](#)

Arts & Humanities Citation Index është një platformë indeksuese në kuadër të WOS, në këtë platformë janë të indeksuara më shumë se 1500 revista shkencore nga Artet, Shkenca Humane, Gjuhë dhe Letërsi, Poezi, Muzikë, Studimet Orientale, Filozofi, Arkeologji, Arkitekturë, Histori, Fe, Televizion, Teatër dhe Radio.

## • Revistat e indeksuara në [Social Sciences Citation Index](#)

Social Sciences Citation Index (SSCI) është një platformë indeksuese në kuadër të WOS, në këtë platformë janë të indeksuara rreth 3000 revista shkencore nga shkenca shoqërore.

## • Revistat e indeksuara në [Emerging Sources Citation Index](#)

Emerging Sources Citation Index (ESCI) është një platformë e re indeksuese në kuadër të WOS. Revistat që janë të indeksuara në ESCI janë revista potenciale për t'u indeksuar në njërin nga platformat më cilësore të WOS - Science Citation Index Expanded (SCIE).

- [Art](#)
- [Gjuhë dhe Linguistikë](#)
- [Linguistikë](#)
- [Shqyrtime letrare](#)
- [Teori dhe Kritikë Letrare](#)
- [Letërsi](#)
- [Letërsi-Romantikë](#)
- [Histori](#)
- [Histori dhe Shkenca Sociale](#)

## • **Revistat e publikuara nga botuesi “Elsevier”**

Elsevier është një kompani analitike e informacionit shkencor me seli në Holandë. Elsevier është themeluar në vitin 1880 si një kompani botuese, e cila veprimtarinë botuese e ka ende aktuale. Përveç tjerash, produktet e kompanisë Elsevier përfshijnë edhe koleksionin e revistave elektronike shkencore ScienceDirect, të cilat revista janë po ashtu elitare në shumë fusha të shkencave natyrore, shkencave sociale e humane dhe arteve. Në këtë kompani botuese–shkencore botohen rreth 2500 revista shkencore nga fusha të ndryshme, ndër-sa, shumica e revistave që botohen nga Elsevier janë të indeksuara në databazat e njohura: SCOPUS dhe WOS.

- [Gjuhë dhe Linguistikë](#)
- [Histori](#)
- [Art dhe Shkenca Humane](#)

## • **Revistat e publikuara nga botuesi “Springer”**

Springer është një kompani botuese me seli në Gjermani e cila boton libra dhe revista shkencore. Në këtë kompani botuese–shkencore botohen rreth 2900 revista shkencore nga fusha të ndryshme. Shumica e revistave që botohen nga Springer janë elitare në fushat e tyre, vlen të theksohet se rezultatet më të rëndësishme në disa fusha të shkencave natyrore dhe shoqërore janë publikuar pikërisht në revistat e Springer-it. Po ashtu, shumica e revistave që botohen nga Springer janë të indeksuara në databazat e njohura: SCOPUS dhe WOS.

- [Kategoria: Arsim dhe Gjuhë](#)

## • **Revistat e publikuara nga botuesi “Taylor & Francis”**

Taylor & Francis është një kompani ndërkombëtare me seli në Mbretërinë e Bashkuar që boton libra dhe revista shkencore. Kompania u themelua në vitin 1852. Taylor & Francis konsiderohet si botuesi më i madh i librave dhe revistave shkencore brenda shkencave humane dhe shoqërore. Taylor & Francis publikon më shumë se 2,500 revista shkencore dhe më shumë se 6,000 libra të rinj çdo vit. Ndërsa, një pjesë e konsiderueshme e revistave që botohen nga Taylor & Francis janë të indeksuara në databazat e njohura: SCOPUS dhe WOS (Web of Science).

- [Art](#)
- [Shkenca Humane](#)
- [Gjuhë dhe Letërsi](#)
- [Muze dhe Studime të Trashëgimisë](#)